



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Nr. __ 64__ Prot.

UDHËZIM

Nr. _04_, Datë _11. 04. 2017

I MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 02, DATË 30.11.2017

PËR

**MËNYRËN E PARAQITJES SË RAPORTEVE SHKENCORE
(STUDIMEVE) PËR PROJEKTET QË FINANCOHEN NË KUADRIN E
PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT E ZHVILLIMIT**

Viti 2017

A. Struktura e paraqitjes së Raportit Shkencor (Studimit) 3

B. Anekse

Aneksi 1. Forma e Kapakut të Raportit Shkencor (Studimi) 6

Aneksi 2. Situacioni i shpenzimeve 7

Aneksi 3. Skeda Informatike 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr __ 64__ Prot

UDHËZIM

Nr. _04_, Datë _11. 04. 2017

**PËR
MËNYRËN E PARAQITJES SË RAPORTEVE SHKENCORE (STUDIMEVE) PËR
PROJEKTET QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE KOMBËTARE TË
KËRKIMIT E ZHVILLIMIT**

Në bazë të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për Shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", të VKM. Nr. 607, datë 31.08.2016, "Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", (AKKSHI), dhe në bazë të VKM Nr. 567, datë 23. 10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike", Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

UDHËZON:

Në përfundim të çdo projekti për kërkim e zhvillim përpilohet raporti shkencor (studimi) përkatës. Ky raport, si dhe dokumente të tjera që përcaktohen në këtë udhëzim i paraqiten institucionit financues përgjegjës (ministri apo institucion qendror), brenda afatit të parashikuar për përfundimin e projektit.

Raporti shkencor (studimi) paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:

- 1. Kopertina sipas modelit bashkëlidhur. (Aneksi I)**
- 2. Përmbajtja e lëndës, ku jepet emërtimi i kapitujve e nënkapitujve dhe numri i faqeve përkatëse.**
- 3. Lista e shkurtimeve të termave të përdorura (Faqe më vete).**
- 4. Lista e ilustrimeve (figura, grafikë, harta, skica, etj.) (Faqe më vete).**
- 5. Hyrja**

Në mënyrë përmbledhëse jepen të dhëna lidhur me :

 - a. Programin Kombëtar të Kërkimit dhe të Zhvillimit dhe problemet e programit të cilave u referohet projekti;
 - b. Objektivat dhe rezultatet kryesore të arritura;

- c. Organin financues dhe financimin nga buxheti i shtetit dhe burimet e tjera në qoftë se ka.
- d. Organizmat shkencore bashkëpunëtoare të vendit dhe të huaja;
- e. Personelin shkencor të projektit.
- f. Periudha në të cilën u realizua projekti;
- g. Botimet në revista shkencore të vendit dhe të huaja, monografi apo referimet në aktivitetet shkencore të realizuara në kuadrin e projektit;
- h. Përfituesit nga projekti
- i. Pronësinë mbi studimin sipas përcaktimeve në kontratë.
- j. Mund të trajtohet edhe ndonjë çështje tjetër specifike që autorët e gjykojnë të nevojshme.

6. Rezultatet shkencore të projektit.

- a. Paraqitja e gjendjes së studimeve dhe nivelit të njohjes në momentin e fillimit të projektit.
- b. Paraqitja e plotë e problemeve të trajtuara duke filluar nga shtjellimi teorik, metodat, teknikat dhe eksperimentet e kryera për studimin, deri tek rezultatet e arritura dhe vlerësimi i saktësisë së tyre.
- c. Paraqiten skica, harta, prerje, diagrama, bllok skema, programe llogarritëse, grafikë, modele, fotografi, pasqyra e tabela të analizave dhe të dhëna të tjera të nevojshme për të bërë sa më të plotë parashtrimin e metodave dhe rezultateve të studimit.

Të gjitha këto sipas natyrës dhe specifikës së fushës shkencore dhe problemit që studiohet paraqiten në disa kapituj dhe nënkapituj në atë mënyrë që gjykojnë më të përshtatshme autorët e studimit.

7. Përfundime :

- a. jepen përfundime lidhur me objektivat dhe rezultatet e projektit duke i mbështetur me vlerësime cilësore dhe sasiore.
- b. paraqiten arritjet më kryesore me vlera shkencore e praktike dhe mosrealizimet, shkaqet e tyre dhe ndikimi në realizimin e qëllimit të projektit.
- c. jepen shpjegime lidhur me mundësinë dhe rrugët për komercializimin e rezultateve të projektit;
- d. jepen përfundime lidhur me avantazhet dhe kufizimet e metodave të përdorura gjatë studimit, si dhe për çështje të tjera që gjykohen me interes nga autorët.

8. Rekomandime.

Jepen rekomandime lidhur me:

- a. zbatimin e rezultateve të studimit dhe përfituesit e mundshëm të tij.
- b. vazhdimin e studimeve në drejtime dhe / ose aspekte të tjera të problemeve të trajtuara.

- 6. Literatura.** Jepet literatura e përdorur (e vendit dhe e huaj) duke dhënë autorin, titullin e plotë, revistën shkencore, botimin ose arkivin ku është depozituar, vitin e botimit dhe shtëpinë botuese.

II. Dokumente të tjera

Bashkë me raportin shkencor (studimin) institucionit finacues i dërgohen dhe;

1. Situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas pasqyrës bashkëlidhur (Aneksi 2). Bëhen komentet e nevojshme.
2. Vlerësimi i ekspertizës së bërë nga institucioni shkencor përgjegjës për projektin.
3. Vendimi i Këshillit Shkencor të institucionit shkencor përgjegjës.
4. Skeda informative sipas modelit bashkëlidhur (Aneksi 3). Pika 11 dhe 12 e skedës plotësohet nga institucioni financues.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GERON KAMBERI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI QENDROR
INSTITUCIONI SHKENCOR**

RAPORT SHKENCOR (STUDIMI) I PROJEKTIT Nr. _____

(Jepet titulli i plotë i projektit)

Drejtori i Institucionit Shkencor

Autorë

Emri
Vula

Qyteti, muaji, viti

SITUACIONI PËRFUNDIMTAR I SHPENZIMEVE TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi	Financimi							
		Nga AKKSH I		Nga Ministria		Nga vetë		Gjithsej	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt

230 Shpenzime

1. Studime fizibiliteti
2. Të tjera

231 Shpenzime kapitale**T O T A L I:****Drejtuesi grupit kërkimor****Përgjegjësi i financës****Drejtori institucionit**

SKEDË INFORMATIVE

E RAPORTIT SHKENCOR (STUDIMIT) PËR PROJEKTET QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT

1. Numri i projektit.
2. Titulli i projektit (studimit).
3. Institucioni përgjegjës.
4. Vendndodhja e studimit.
5. Drejtuesi shkencor i projektit (studimit) dhe bashkëpunëtorët shkencor.
6. Data e përfundit të studimit.
7. Numri i faqeve të studimit.
8. Numri i ilustrimeve (figura, harta, etj.).
9. Fjalët kyç.
10. Përmbledhje për përmbajtjen e studimit me jo më shumë se 1000 karaktere (rreth 10-15 rreshta).
11. Fondi i shpenzuar për studimin në mijë lekë.
12. Ekspertët e misionit të vlerësimit të institucionit.
13. Ekspertët e misionit të vlerësimit të institucionit financues.